

BIBLIOTEKA

E

8 JH-1  
R 95

GJIROKASTER

SHTETIT

Skënder  
Rusi

# Lirikë

poezi

8JH-1  
285

Skënder

Rusi

LIRIKË

poezi \*



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

**Redaktor**

**PERIKLI JORGONI**

PERIKLI JORGONI  
SLOVENSKA MUDRANICA

## K o m u n i s t i

E lanë dy ditë përdhe,  
dhe roja ata vunë trefish,  
akoma e shihnin me tmerr,  
megjithëse i vrarë ai ish.

Dhe çdo gjysmë ore ata  
qëllonin në qìell më kot.  
Nazistë kish në çdo hap,  
ndaj s'mund t'i afroheshe dot.

Ditën e tretë në të gdhirë,  
i vrari atje më s'u pa,  
veç lule edhe trëndafilë  
në vend të tij panë ata.

E lanë dy ditë përdhe,  
të tretën veç lule atje kish,  
megjithëse lëshonin batare  
dhe roja kishin vënë trefish.

## *Nevrus Gjoza*

Pastaj ata e dogjën,  
(kuptohet, pasi u vra)  
— Nuk ka më Nevruz Gjozë! —  
lëshuan fjalë ata.

Nuk ka më sy të tij,  
as bebëza që flasin,  
as duar, as fytyrë,  
as pushkë të na vrasë.

Çdo gjë ne ia dogjëm  
edhe ia kthyem në hi.  
— Nuk ka më Nevruz Gjozë! —  
klithën ata përsëri.

Veç yllin e tij, kurrë  
s'e dogjën dot ata,  
gjithnjë e më i kuq  
bëhej ai në zjarr.

## *Punëtorët e fierzës*

Erdhën nga të gjitha anët  
dhe ishin të ndryshëm në moshë.  
Nuk kishin emra me famë,  
po quheshin thjesht punëtorë.

O Muji, edhe ti, Halil,  
që flini thellë në bjeshkë,  
asnjëri nuk ishte kreshnik,  
nga ata që erdhën në Fierzë.

Asnjëri nuk foli me zanat,  
as i thirri ato në ndihmë.  
Me duart e tyre të ashpra  
ata Fierzën e ngritën.

Dhe digës që ngritën ata,  
kthimit të ujit në dritë,  
nuk mundet ndryshe t'i thuash  
përveçse epos kreshnik.

## *Ndajnatë*

Po erret. Domethënë ndajnatë.  
Dëbora zgjat kokën te dritarja.  
Më gishtérinjtë e saj delikatë  
seç vizaton nëpër xhamë.

Seç kërkon të më thotë,  
ku ta dish atë gjuhën e saj?  
Mijëra flutura nga qielli  
vijnë edhe mbesin mbi xham,

ndërsa ti je larg,  
kilometra të tërë prej këtej.  
Këto flutura të bardha mbi xham,  
ku ta dish, mbase ti m'i hedh.

Edhe atje është ndajnatë,  
ti nga turni kthehesh tani,  
Peliçen e heq vetë nga krahët,  
dhe këpucët vetë i zgjidh.

Më vjen keq që duart e mia  
nuk janë pranë tëje, i dashur.  
Më vjen keq tani për të gjitha,  
sepse fajin vetë e kam pasur.

Këto xama ku ballin kam mbështetur,  
që s'më lanë në kantier të vij,  
nuk do t'ia lë dëborës, as erës  
do t'i thyej vetë, ta dish.

Do t'i thyej vetë, ta dish,  
me duart e mia delikate.  
Jetë mës xhamash, vdis!  
Tungjatjeta, ti, jetë e madhe!

## *Partizani*

E solli lufta që një ditë  
të mbronte gjithë skuadrën.  
Dhe për çdo shok, nga nazistët  
mori nga një plagë.

Në torbën që e mbante pranë  
një bukë misri gjetën.  
Me shokët priste që ta ndante,  
si mund ta hante vetëm?!

Çdo gjë ata në këtë luftë  
njéri-tjetrit ia jepnin.  
Veç vdekjet, sado që të ishin,  
ia merrnin njëri-tjetrit.

## *Vendosmëri*

Ora dymbëdhjetë. Mesnatë.

Te dritarja një grua e bukur, flokëverdhë.

Sahati si gjithnjë tik-tak, tik-tak,

i tregon asaj se akoma duhet të presë.

Ajo është e re, e sapo martuar,

dhe i shoqi inxhinier në një uzinë gjigante,

Por ajo asnjëherë nuk është ankuar,

që ai rri vonë deri pas mesnate.

Ai është atje, — mendon ajo në dritare,

kjo do të thotë që ai është në luftë.

Do t'i ngremë furrnaltat vetë ne, shqiptarët,

armiq, që ikët, humbët:

Do t'i ngremë furrnaltat vetë ne, shqiptarët,

dhe çdo lumë në Shqipëri do ta kthejmë në dritë.

Do t'i ngremë me duart tonë gjigantët,

prapa diellit, armiq që ikët!

Po gdhin dhe ai ende s'ka ardhur.  
Eshtë atje, mes shokëve, mbi projekte,  
që Shqipëria të mbetet gjithnjë e pavarur,  
për jetë të jetëve.

## *Dy Qetë*

Punuuan gjersa u plakën bashkë.  
Dhe nuk u ndanë asnjëherë.  
I ziu në anën e majtë,  
i bardhi në anën tjetër.

Kur ishin të vegjël, livadheve  
çuditeshin atëherë të gjithë.  
I bardhi s'rrinte me të bardhët,  
i ziu s'rrinte me të zinjtë.

Kjo ishte e vetmja arsyé,  
që u vunë të dyve një zgjedhë.  
Punuuan kështu shumë vite  
dhe nuk u ankuan asnjëherë.

Kujtonin të dy fëmijërinë,  
kur bridhën livadh më livadh,  
kuptohet, me sy ata flisnin,  
se gojën kishin për bar.

Nuk mundi tē ecë më dot.  
Dhe ja, pér këtë i vjen keq.  
Të bardhin në sy e shikon  
dhe lotë nga sytë ai nxjerr.

Unë s'isha atje, nuk e pashë.  
Por ama, xha Rizai s'gënjen,  
se qetë dinë tē tē flasin,  
në qoftë se nga afér i njeh.

## *Vajzë që martohesh nesër*

Vajzë që martohesh nesër  
edhe flokët i bëre me dallgë,  
përse mban fytyrën të fshehur  
nën atë shami të bardhë?

Unë dua që botën ta shohësh,  
jo më, nëpërmjet shemisë,  
Jepua fëmijëve të lozin,  
po qe se nuk do që ta grisësh!

Jepua fëmijëve shaminë,  
që nesër për valle ta kenë!  
Flokkët si ar ty të ndrijinë,  
leri mbi supe të bien.

Vajzë që martohesh nesër  
edhe flokët i bëre me dallgë,  
mos m'i lër sytë të më dhemin,  
grise atë shami të bardhë!

## *Shqetësim*

Eshtë një mësues të një fshat i bukur,  
që di shumë gjëra, që fshatarët s'i dinë,  
Por ata s'e përfillnin, bile edhe rrugët  
i ngrejnë pluhur dhe ia shtojnë mërzinë.

Ai nuk u flet fshatarëve në rrugë  
edhe psherëtin, dreqi e marrtë!  
Harron se fshatarët e rritën me bukë  
dhe i dhanë shkollë të lartë.

Ju pse habiteni, o njerëz të mirë,  
me këtë mësues në këtë fshat të bukur,  
që di shumë gjëra që fshatarët s'i dinë,  
por që s'e përfillin as njerëzit, as rrugët.

## *Eriona*

Sot është e shtunë dhe nesër  
Eriona ka ditën e dasmës.

Në oborr, të lulishten e gjelbër,  
që tani vallëzojnë tulipanët.

Ca shoqe të saj me kujdes  
ia kreñnin flokët e lëshuar mbi supe.  
Të bëhet më e bukur për shkak të së dielës,  
për shkak të mëngjesit që do të quhet i nuses.

Po qenka e çuditshme kjo nuse,  
dhe qenka e çuditshme kjo vajzë,  
pa vello, pa buzë të kuqe,  
pa tel, pa fustan të bardhë.

Në vend të tyre, nusja  
paska veshur kostum popullor.  
A nuk është kështu, më e bukura  
nga të gjitha nuset në botë?

Sot **është** e shtunë dhe nesër

**Eriona** ka **ditën** e **dasmës**.

Në oborr, në lulishten e gjelbër,

që tani vallëzojnë tulipanët.

zgjedhje e shtunës së Erionës  
në oborr, që varet nga gjelbëri i lumenjve.  
Oborrët e gjelbërit janë vallëzojnë  
tulipanët, që varet nga gjelbëri i lumenjve.

zgjedhje e shtunës së Erionës  
në oborr, që varet nga gjelbëri i lumenjve.  
Oborrët e gjelbërit janë vallëzojnë  
tulipanët, që varet nga gjelbëri i lumenjve.

zgjedhje e shtunës së Erionës  
në oborr, që varet nga gjelbëri i lumenjve.  
Oborrët e gjelbërit janë vallëzojnë  
tulipanët, që varet nga gjelbëri i lumenjve.

## *Nxenësit e mi*

Ngrihen një nga një me drojtje  
por u përgjigjen të gjitha pyetjeve.  
Skuqja e tyre më pëlqen,  
ka diçka nga prilli i pemëve.

Pak bukë e kanë vënë në çantë,  
ja, aty, midis librave.  
Ndonjërit edhe i hahet  
nga lodhja e rrugës kur vinte.

Dhe ndodhte që ndonjëherë,  
kur dora në çantë i futej,  
ngatërronte librat me bukën  
dhe prapë në fytyrë skuqeji.

Janë, fare, fare të vegjël,  
por duan të njojin shumë gjëra.  
Ngrihen në këmbë edhe pyesin,  
dhe duan t'i dinë të tëra.



I shoh një nga një me radhë  
dhe ndalem pak në secilin.  
Vërtet, fytyrat e tyre  
kanë diçka të bukur nga prilli.

Më ndodh shpesh që të ulem  
në një bankë bashkë me ta.  
Kjo do të thotë që nga prilli i tyre  
edhe unë të këm diçka.

## *Nga ditari i një partizani*

Bile, në të dhjetën e sekondës,  
bie nga një predhë që lart,  
Tani në përbërjen e tokës  
më shumë se dhe, ka metal.

Po sado të vazhdojë kjo luftë,  
sado gropë të hapen prej saj,  
popullin e tërë ajo kurrë  
s'është e mundur ta futë në varr.

Dëgjo ti, Gjermani e madhe,  
dëgjo ti, Hitleri i saj,  
kjo tokë s'jua fal të vrarët  
që ju i shkaktuat asaj.

Të gjallët që do mbeten këtu,  
do ngrenë fabrika gjigande,  
Këtë hekur që na e hodhët ju  
do t'ua kthejmë në lodra kalamajve.

Do t'u themi pastaj tē värtetën  
pär metalin e lodrave tē tyre.  
Sa herë që me duar t'i prekin  
t'u zmadhohen bebëzat e syve.

## *Në shah*

Po bie mbrëmja qetë-qetë,  
me shokun tim unë luaj shah.  
Vërtët, këtu ka edhe mbretër,  
po ne i komandojmë ata.

E treta radhë që fitorja  
veç mua po më buzëqesh.  
Ky shoku im pi cigare,  
një shuan dhe një tjetër ndez.

Kur ja, tek xhami afër derës  
keq befasisht u shfaqe ti,  
**dhe na vështrove duke qeshur,**  
po kujt i qeshe, nuk e di.

Sa kohë ndenje pranë nesh,  
aq herë unë u zura mat.  
Tani e kisha unë radhën  
t'i pija cigaret me inat.

Një mijë lojë të bëj tani  
unë do t'i humb një e nga një.  
Sa kohë që endë nuk e di:  
për mua erdhe a pér të.

Një mijë mbretër shoku im  
le të m'i zërë mua mat,  
mjafton që ti të më kuptosh,  
se ardhja jote u bë shkak.

## *Vaditësit*

Gjithë natën jashtë.  
Hënën si fener e përdorin mbi ujëra.  
Në bar gjejnë zërin e gjinkallës,  
nën mollë guit guguçja.

Kanë etje bimët.  
Lumi e thau shtratin për to.  
Ja edhe pikat e djersës,  
tokë, prodho!

Gjithë natën në këmbë,  
guguçen e zuri gjumi nën mollë.  
Si fener ata kanë hënën  
dhe janë të lumtur, megjithëse itë lodhur.

## *E zakonshme*

Jashtë bie borë, era fryn e rreptë,  
kali i një karroce vrapit seç ia merr.

Karrocieri i fshatit vërshëllen e qesh,  
kamxhikum prej gome mbi dëborë e dredh.

Edhe nëpër rrugë rendin — rendin rrotat.  
Nja dy harabelë dridhen nga të ftohtët.

Mollët gjetherëna, me trupin e hollë,  
me qafën mbështjellë me shall prej dëbore.

Edhe rend karroca në rrugën me gurë,  
nën bark të kalit lodhja bëhet, ujë.

Dhe fshati pret filmin, jepi, karrocier,  
le të bjerë borë, le të fryjë erë!

## *Nuk është aq e thjeshtë*

Nuk është aq e thjeshtë  
si dy e dy bëjnë katër,  
por ama është e vërtetë  
që kjo është dashuria më e pastër.

Dhe ajo vajza juaj,  
megjithëse e keni të vetme,  
do të shkojë atje ku e caktuan,  
në thellësi të bjeshkëve.

Mjerë ai që s'e kupton drejt  
se kjo është dashuria më e pastër,  
megjithëse nuk është aq e thjeshtë  
si dy e dy bëjnë katër.

## *Meditim*

Ikin, shtegtojnë zogjtë  
tutje detesh plot tallaz.  
Vetëm në këtë vend të botës  
nuک u shkojnë atyre pas.

Vetëm në një vend të botës  
janë një të kaitër stinët.  
Shqipëria e palodhur  
ka pranverë edhe në dimër.

Shqipëria e palodhur  
nuک e njeh mërgimin më.  
Vetëm në një vend të botës  
mund ta shohësh ti këtë.

S'ka këtu lëndina lotësh  
vende dramash të mëdha.  
Ikin, ikin vetëm zogjtë,  
shtegtojnë veç ata.

## *Po të më pyesin*

Janë fëmijë me sy plot drjatë,  
me shallin e pionierit në qafë.  
Po të më pyesni për zogjtë më të bukur,  
do t'ju tregoja, jo... ata.

Po të më pyesni ç'ngjyrë ka gëzimi,  
do t'ju tregoja fytyrat e tyre me radhë.  
(Në klasën e gjashtë nuk vjen agimi,  
pa ardhur ata më parë).

Po të më pyesni pse për t'i rënë më shkurt  
e kapëroej disa herë këtë lumë të madh,  
do t'ju tregoja me radhë sytë e gjithë nxënësve  
të klasës së gjashtë.

## *Karrocieri*

Ai u ngrit natën nga shtrati,  
Flinin gruaja dhe fëmijët.  
Në errësirë i gjeti rrobat  
dhe u vesh në errësirë.

Binte nëpër gropë e ngrihej prapë,  
mbulohej me dëborë i tëri,  
gjersa vajti më në fund në stallë  
pranë kalit të bardhë të tij.

Ai e ngriti kokën dhe hingëlliu lehtë,  
ia shkund nga supet dëborën e dimrit.  
— Ngrive? — i tha pastaj karrocieri  
dhe e përkëdheli me duart që i dridheshin.

Dhe i hodhi mbi kurriz për ta mbuluar  
mbulesën e leshtë që kish sjellë me vete.  
Gënjen ai që thotë nuk qajnë kuajt,  
kur preken nga dashuria e njerëzve.

Në sytë e mëdhenj të kësaj kafshe të urtë  
dolën lotët si kokrra bajame.  
Kuajt nuk dinë të flasin, prandaj  
prodhojnë lot në vend të fjalëve.

## *Vajzë*

Ka qenë një kohë kur unë ty  
të thërrisja e dashur dhe ti qeshje  
Atë kumbullën e vogël që kisha te dritarja  
e bëje ti çelte

Edhe ato dy dallëndyshet e bukura,  
që mbushnin oborrin tonë me cicërima,  
loznin në qìell që ty edhe mua  
të na dukej më e bukur dashuria.

Isha aq i mirë atje, brënda  
syve të tu të mëdhenj,  
po mua më mungonin ca gjëra,  
që ti i gjete atje, në qytet.

Nga doli ajo erë brenda syve të tu,  
që më nxorri mua përjashta?  
Lulet e kumbullës të gjitha u shkundën,  
u drodh nga dhimbja dritarja.

Edhe dallëndyshet (ti e mban mend?)  
ikën më parë se çdo herë tjetër.  
Thua nga ndarja jote dhe imja  
të ketë ardhur dimri më shpejt?

Ndoshta, Shumë gjëra ndodhin  
në këtë jetë, moj vajzë.  
Një gjë dije: dallëndyshe si ato  
në oborrin tënd s'kanë për të ardhur.

## *Pensionisti*

Dhe u ul mbi brazda për t'u çlodhur,  
dhe nxori kuti në me duhan të grirë,  
dielli ulej pas Moravës, ndoshta i lodhur,  
qetë copëtonin misërishtet me brirë.

Ish zemëruar me të gjithë atë mëngjes.

Edhe me kryetarin plaku bëri fjalë:

— Mbi këto brazda, — i kish thënë, — dua të vdes,  
do t'i le, kur shpirti të më dalë.

Nuk dua pension, or tungjatjeta.

Mbaje për vete, o kryetar.

Kam edhe ca rrugë në këtë jetë,  
kam edhe ca brazda për të çarë. —

U ngrit pastaj dhe përsëri i mbrehu qetë.

Brazda të tjera xha Rizanë e joshën.

Dielli po ikte, për të ardhur nesër,  
ai lëronte pa pyetur moshën.

## *Balta*

Po bien prapë gjethet  
dhe qiellit u bë gri.

Në rrugë prapë pellgje  
dhe baltë përsëri.

Me çizme nëpër baltë  
unë shkoj e vërvshëllej.  
Mëngjes qoftë a ndajnatë  
një këngë do ta gjej.

Se tokën e kam timen  
dhe kjo nuk është pak.  
Ndaj nuk i var turinjtë  
kur balta më spërkat.

Ju bini, gjethe, bini.  
Ti bjerë, shi, që lart.  
Unë baltën e kam timen,  
më duket si asfalt.

## *Kuptoje*

*I iħuaj nxenēsse tē ikin.*

*Konsultime nuk do bējnē.*

*— Prapē do tē ikēsh?*

*(Nga biseda midis dy mësuesve)*

Dhe ikēn ti nē Korċēn tēnde  
ku xhiro ka e bulevard,  
dhe vajza qē ta marrin mendjen  
me traketruket mbi asfalt.

Njē nga njē nxenēsit tē gjithē  
me çanta krahēve vijnē varg,  
dhe manushaqe kanē mbledhur  
pēr vazon tēnde mbi krevat.

Se ata janē ende tē vegjēl  
dhe s'e kuptojnē dot aspak,  
se fshati i tyre edhe rrugët  
pēr ty paskan shumē baltē.

Se janë ata ende të vegjël  
dhe s'e kuptojnë dot aspak,  
se ikja jote dhe jo ata  
për notat katra është shkak.

Kuptoje pra zërin e tyre,  
që të thërret, që të kërkon,  
Kuptoje dashurinë e syve,  
kuptoje kohën që jeton.

## *Ura Bruklinit, 1978*

Henri nga Nju-Jorku, 23-vjeçar,  
i diplomuar për dramaturgji,  
zgjodhi urën e Bruklinit me emër të madh,  
dhe kjo ish e vetmja padrejtësi e tij!

Shteti borgjez u zemërua për këtë.  
Ç'është kjo sfidë për artin tim?  
Fundja, ka vende të tjera për të vdekur,  
ka ura të tjera pa mbarim.

Dhe nënës së Henrit nuk i dhanë të drejtë  
të kërkonte trupin e djalit të saj.  
«Atje le të luajë drama, — tha shteti borgjez,—  
atje le të bëhet artist i madh.

Atje le të luajë me peshqit e gaforet,  
atje le të gjejë punë, le ta paguajnë ata.»  
Dhe qeshi me të madhe shteti borgjez,  
megjithëse ish në zemërim të madh.

O ti, shtet, që do më tepër urat  
dhe i ekspozon si kryevepra arti,  
dije, se një ditë do të përgjigjesh  
për vdekjen tragjike të këtij djali.

Dhe patjetër pér ty fundi do të vijë,  
sepse, jo të gjithë si Henri kanë pér të vdekur  
Shtet borgjez, dëgjomë mirë:  
më s'ke pér të qeshur!

## *Grua*

Po bëhet vonë.

Ti më pret te dritarja, duke vështruar jashtë.  
Me sytë e médhenj kërkon të më shohësh,  
më mëndje mundohesh të më kapësh.

Vajzën ka kohë,  
që e ke vënë në krevat, në gjumë.  
Ajo është fare e vogël,  
s'e kuption dot përse jashtë rri unë.

Ajo është fare e vogël  
për ta kuptuar se ai gjumi i saj,  
mund të prishet, bile, në sekondë,  
po s'e mbajtëm pushkën në krah!

## *Opingat*

Ato s'kanë xhufkë sipér.  
Aq tē bucura nuk janë.  
S'kanë asnje tē qëndisur,  
asnje lulkë sipér s'kanë.

Ato fushën kanë skenë,  
erën kañe duartrokitje.  
Nëpér brazda valle hedhin,  
nëpér baltra ato grisen.

Ndodh kur çlodhen nëpér brazda,  
qetë e urtë i lëpijnë.  
Si qëndisma tē mëndafshta  
ndritin jargët mbi opingë.

## *Shoqërore*

Ti s'erdhe mbrëmë dhe nuk bëre mirë,  
që çmove më tepër gruan dhe përkëdheljet e saj.  
Sepse, aty, nën shi, ishte lufta për socializëm,  
dhe jo nën llambën e abazhurit të kaltër.

Dhe aty, nën shi, ishin shokët e tu.  
Dy prej tyre morën edhe plagë,  
që ti dhe gruaja jote, që e do aq shumë,  
përherë bukën ta hani të bardhë.

Dhe aty, nëpër dallgë, nën shi  
ne njëri-tjetrin e njohëm shumë më tepër.  
Dhe e kuptuam se që të bëhet njeri jo i mirë  
mjafton dhe një natë e tillë vetëm.

Mjafton dhe vetëm një natë e tillë me luftë,  
kur ardhjen tënde e ke në dorë ti vetë.  
Sepse socializmin ne nuk e mbrojmë me urdhër,  
po me dashurinë e komunistit që kemi në zemër.

Ti s'erdhe mbrëmë dhe nuk bëre mirë.  
Dy nga shokët e tu morën edhe plagë,  
edhe ata janë kështu si ti, të rinj,  
dhe jo më pak se ti i duan gratë.

Por duan shumë dhe ata  
qindra kuintalë, që nga përmbytja i shpëtuan.  
Që vendi yt i pavarur përherë të mbetet,  
dhe përherë të kesh bukë ti bashkë me gruan.

## *Kurbatka*

Në shtëpinë time një mëngjes  
erdhi një kurbatkë me dy sy në zez.

Në sup dymbëdhjetë shosha kish vënë.  
Nuk kishte as baba, as nënë.

Në gropat e syve udhët i kish mbjellë.  
Me një shall jeshil qafën kish mbështjellë.

Dhe në duar trembëdhjetë unaza kish vënë,  
kurbatka me vetull si hënë.

Fillova ta shoh kurbatkën nxituar,  
një herë në sy, një herë në duar.

Më fali një unazë vogëlushja jetime.  
Eh, moj kurbatkë, e mira ime.

E shihni këtë unazë ngjyrë ari?  
Një jetime syzezë në fëmijni ma fali.

Që atëherë në fshat ajo s'është dukur.  
Në një qytet të madh punon kurbatka sybukur.

Dhe shosha, unaza nuk mban më në duar,  
me njerëz të rinj ajo u bashkua.

Atje në uzinë, duke shkrirë hekur,  
shkriu dhe unazat që i kishin mbetur.

## *Kur bie borë*

— Nxënësve të mi —

Ata vijnë nga larg  
nga dy ose nga tre.  
Dëbora supet ua lag  
dhe faqet ua rreh.

Po dimrin s'e përfillin,  
mëgjithëse janë të vegjël,  
veç librat e fletoret  
dëborës ia fshehin

Prandaj herë pas here  
me sy shohin nga çanta.  
Pas gjoksit e shtrëngojnë  
dhe rendin me të katra.

I shoh që nga dritarja  
tek vijnë që nga larg  
dhe ulem i fryj zjarrit  
të bëhet bubulak.

## *I n t i m e*

Jam këtu midis zogjve dhe erës,  
pranë fëshfërimës së gjetheve, midis fijeve të barit.  
Kush e bëri këtë grurë si det  
muaji maj apo duart e tua, e dashur?

Jam këtu midis zogjve dhe erës,  
pranë udhës së diellit, te ky mëngjes i kaltër.  
Kush i tha atij të kalojë afër meje  
tërheqja e tokës apo ti, e dashur?

Jam këtu midis zogjve dhe erës,  
nën këta plepa të mbushur me cicërima.  
Kush u tha atyre të këndojojnë përmua  
qielli i kaltër apo dashuria?

Jam këtu, midis zogjve dhe erës,  
pranë fëshfërimës së gjetheve, midis fijeve të barit.  
Dhe e kuptoj që edhe në grurin, edhe në zogjtë  
dhe në çdo gjë të bukur, je ti, e dashur.

## *Në lëmin e fshatit*

Shi.

I argjendtë e pak i artë.  
Gjer në zemër të hyjnë  
vetëtimat që vijnë nga lart.

Unë nxora xhaketën e re  
dhe e hodha mbi grurë.  
Ty t'u lagën flokët edhe supet  
dhe e hutuar vështrove nga unë.

Pastaj më thirre në emër.  
Dhe u tulate e lagur në krahët e mi.  
Po të kishe xhaketë, përpara se mbi mua  
do ta hidhje mbi grurin e ri edhe ti:

Shi.

I argjendtë e pak i artë.  
Do të dalë dielli, e di  
e do na mbështjellë me krahët e zjarrtë.

## *Njoh një njeri...*

Njoh një njeri të rrallë,  
një lumë me fjalë të bukura,  
ai të ze mik në çast,  
të mbyt pastaj me të puthura...

Edhe në qofsh ti i verbër,  
në qiell ai sytë t'i ngre,  
t'i krahason ata me liqene,  
me dete blu, të mëdhenj.

Por ti mos u çudit kjo,  
që t'u ndodh kaq pranë ky njeri.  
Ai lajkat s't'i bën si epror,  
po si shok i eprorit të tij.

Që nesër ose pak më vonë,  
të mund t'ia thuash një fjalë,  
për ta ngritur, për shembull në rrogë  
për ta ngjitur, për shembull më lart.

Se çdo gjë ai jep,  
kërkon t'ia ktheshe me kamatë,  
fjalët e bukurë edhe buzët  
i përdor si t'i kishte armë.

Njoh një njeri të rrallë,  
një lumë me fjalë të bukura,  
nga buzët e tij dalin jargë,  
por asnjëherë të puthura.

Gjithnjë e kam dashur s'ndajv e që  
 freskinë e dorës së saj,  
 ajo flokët e mi i prish  
 dhe i kreh si të ishte vajzë.

Unë s'jám anije me vela,  
 ajo s'më ndihmon të lundroj,  
 por ja që më pëlqen era  
 me ato fëshfërima ngado.

Megjithëse e dua kaq shumë  
 uroj, unë, vdekjen e saj  
 sa herë që nis fryn me jug  
 dhe grurin e bukur e than.

I ndodhur mes dy dashurive  
 unë di kë prej tyre të zgjedh,  
 se jam fshatar më përpara  
 dhe pastaj jam poet.

## *Troket një vishnje*

Troket një vishnje përmbi xham,  
një degë e saj me lule plot.  
Si dora jote ajo më ngjan,  
që zgjatet e s'më takon dot.

Unë ngrihem e dritaren hap,  
po ç'kanë duart që më dridhen?  
Që nga korija vjen një fllad  
dhe mbi jastëk ca lule bien.

Kantieri yt është kaq larg,  
por unë të pres, gjithnjë të pres,  
prandaj kjo vishnje përmbi xham  
më ngjan me ty sa herë troket...

## *B'a b'a i*

Çdo gur që preku imé dörë

Çdo gur që preku imé dörë  
e shndërroi befas në shtëpi  
jo me magji si në përrallë,  
po me çekan, edhe mistri.

Siç qesh pallati kur në të  
hyjnë fëmijët si pëllumba;  
ashtu do ta shikosh gjithnjë  
sa herë vjen ai nga puna.

I bëri njerëzit të hipin  
në kat të pestë edhe më lart,  
për vete kurrë nuk pranoi  
ta lerë shtëpinë e tij në fshat.

## *V i s h o c i c a*

### *- Vendlindjes sime -*

Ti s'më ke dhënë të pi sisë,  
as më ke bërë kokën,  
megjithatë, emrit që ke  
ia dua fort çdo shkronjë.

Ti pellgje ke kur bie shi  
dhe akuj — gjer në mërsi  
megjithatë, unë mirë e di, bë  
ku erën e kam fllad.

Ti stalla ke ku rriten lopë  
dhe baltë gjithandej,  
megjithatë, ti ke një qelli  
që asgjekund s'e gjej.  
  
Veç disa qindra njerëz ke  
dhe disa dhjetëra vajza,  
megjithatë, tek ti, atje  
mua më rron e dashura.

## SHKËPSHËTË VETËM SËV

Dhe sado larg që unë të jem,  
ngado që ta shkoj moshën,  
unë e di mirë se do më lesh,  
një gur ta mbështes kokën.

Shkëpshtë vërtet ëp sëfisë  
dëgjohet që tashmë pa ëp, nuk lidh  
tashmë me këtë vërtetë që përdorë  
ja qëndrueshme. Në këtë rast, që

shkëpshtë vërtet ëp sëfisë  
dëgjohet që tashmë pa ëp, nuk lidh  
tashmë me këtë vërtetë që përdorë  
ja qëndrueshme. Në këtë rast, që

## *Të lutem, hiqe kapelen*

Dora e fshatarit është prilli  
që e bën grurin të qeshë,  
balli i tij është qielli,  
ku shiu që del quhet djersë.

Bukën e bardhë që hamë,  
birra, që aq shumë na pëlqen,  
pjeshkën apo portokallin  
apo qumështin e ngrohtë në mëngjes.

Të gjitha. Të gjitha. Të gjitha,  
i kemi prej lodhjes së tij,  
prandaj, po qe se shkon buzë arës.  
të lutem, kapelen hiq!

## *Fëshfërima e një molle*

Jam unë ajo molla, ku ti  
me vajzën tënde gdhije netët,  
që mos ju shihte asnjeri  
unë gjer përdhe i shtrija degët,

Dhe që t'ju dukej më e bukur  
çdo gjë që thoshit ju të dy,  
unë gjer në maj i mbaja lulet  
dhe ftoja shumë zogj aty.

Dhe di çdo fjalë që u tha,  
dhe di, sa herë ajo u skuq,  
me dhjetëra netë fjalën: mall  
dëgjova pranë fjalës: puth.

Në dasmën tuaj s'erdha dot,  
po tundja degët nëpër erë.  
Në vendin tim dërgova kokrrat  
që të kënaqeshit të tërë.

## Nevada, 1979

Edhe një shpërthim tjetër në Nevada.  
U tmerruan zogjtë, u drodhën yjet.  
Por jo popujt që janë miliarda,  
jo grushtet, jo zëri i tyre.

Uraniumi, dihet, është i tmerrshëm  
e vdes ajrin dhe çdo gjë të gjallë.  
Por popujt, dihet, nuk kanë vdekje.  
Lodhesh kot, Nevadë.

Lodhesh kot që vazhdon të pjellësh  
përbindësha njëri pas tjetrit.  
Popuj, kthejeni atë në shterpe,  
putanën e dreqit!

Popuj, brenda grushtave tuaj  
është vdekja e Nevadës.  
Qëlloni me ta dhe keni për ta kuptuar  
se i përkisni mëngjeseve të kalter.

Qëlloni me ta dhe keni për ta kuptuar,  
sa shpejt do të vdesë Nevada.  
Popuj, në grushtet tuaj  
rron e do të rrojë e ardhmja!

## *Një ngjarje e thjeshtë*

Ema Bregasi, një gruë e mirë,  
me dy fëmijë të vegjël në duart e saj,  
veshur me një fustan të thjeshtë, pa lule  
po shkonte të shihëtë shoqin në spital.

Në çantën e saj — portokaj dhe mollë,  
dhe një vazo e bardhë me mjaltë.  
Megjithatë, dashurinë për të shoqin  
ia lexoje në sy e jo vetëm në çantë.

Hyri në spital dhe i dolën përpara  
mjekë, infermierë, të gjithë.  
— Ai iku — thoshin bluzat e tyre të bardha.  
Ai iku — thoshin sytë.

Ai iku — thoshin lulet përreth.  
Ai iku — thoshin pemët, zogjtë.  
Dhe ajo e kuptoi se ky shqetësim  
qe për të shoqin.

Ata i thanë se i shoqi i saj kishte ikur pa u shëruar mirë. Reparti i ri inaugurohej sot, ndaj mund ta gjente në uzinë.

Ema Bregasi, një grua e mirë, me dy fëmijë të vegjël në duart e saj, e kuptoi se më tepër se asnjëherë e dashuronte të shoqin në këtë çast.

## *Meditim në vjeshtë*

Frym era dhe gjethet që lart  
pikojnë njera pas tjetrës.  
Unë shkel mbi to me inat  
që aq shpejt u vyshkën, u zverdhën.

Dhe qesh si fëmijë pastaj,  
kur mendoj se kjo është dialektike.  
Edhe ti — i them vetes në çast  
një ditë prej ditësh do thinjesh.

Frym era dhe gjethet që lart  
pikojnë njëra pas tjetrës.  
Përsëri mbi to me inat  
unë shkel, pse ato u zverdhën.

Sepse atje lart në plepa  
ka akoma gjethe që mbahen.  
Ato janë ende të blerta  
dhe lozin me erën e tallen...

## *Ardhka një moshë*

Ardhka një moshë, e dashur,  
kur dashuria qenka më e bukur.  
Tani ti s'je më e re,  
por ja që u dashka më shumë.

Çdo fije floku t'u thinj,  
je bërë e bardhë, dëborë.  
Por dua prapë, si dikur,  
t'i prish e t'i kreh ata flokë.

Ndonjë edhe mund, të qeshë.  
Ndonjerës mund, t'i duket përrallë.  
Por ja që ndodhka në jetë  
të luash dhe me flokët e bardhë.

Me dridhje edhe më të madhe,  
se ajo që ke ndier dikur.  
Ardhka një moshë, e dashur,  
kur dashuria qenka më e bukur.

## *P a t j e t ë r*

Ai zbriti nga makina  
dhe u nis në fshatin e tij.  
Me pelice dhe me çizme,  
dukej si tjetër njeri.

Dukej ndryshe pa kravati,  
pa kostumin ngjyrë krejn.  
Si në endërr ai shkelte  
nëpër pellgje të mëdhenj.

Ndanë rrugës në të majtë,  
në një arë me panxhar  
po punonin nëpër baltë  
burra, gra e kalamaj.

Ata njerëz nëpër baltë,  
ata burra, ato gra  
do të gjenin patjetër  
sa i desh ai-ata.

## *M u z i k a n t i*

### **Nga kujtimet e gjyshit**

Asnjëherë në jetën e tij  
nuk i mori ndonjërit para.

Megjithëse, gjer ditën që vdiq  
ai mbeti, thjesht, fukara.

Pak bukë atij i mjaftonte.  
edhe ndonjë gotëz raki.

Nuk deshte aspak varférinë  
t'ua shtonte të varférve ai.

Violina e mbante të gjallë.

Ajo ish për të ngushëllim.

Veç kur martoheshin të pasurit  
nuk pranonte t'i binte ai.

Kështu, fshatrave gjithnjë  
i ra ndër dasma për të tjerë.  
Pavarësisht se për veten e tij  
ai s'pati dasmë asnjëherë.

## SHKONIN E DASMË

SHKONIN E DASMË

Të varfërët nuk patën fat  
t'i shkonin edhe atij në dasmë.  
Ai vdiq, kështu, muzikant  
i martuar me violinën-vajzë.

Por ata e treguan kur vdiq,  
nderimin e madh që patën,  
Mbi varrin e thjeshtë të tij  
hodhën dhë me mijëra të varfër.

Shkoni i tashme, shkoni i tashme,  
shkoni i tashme, shkoni i tashme,  
shkoni i tashme, shkoni i tashme,  
shkoni i tashme, shkoni i tashme,

shkoni i tashme, shkoni i tashme,  
shkoni i tashme, shkoni i tashme,  
shkoni i tashme, shkoni i tashme,  
shkoni i tashme, shkoni i tashme,

## *L i r i k ë*

Fëshëfërin era, gruri përkëdhel  
krahët e mi delikatë,  
Në sytë e mi e ka qiellin kjo mbrëmje  
dhe hënën e ngrënë — në këtë drapër.

Pastaj erdhe ti dhe më shkove  
nëpër flokë dorën që të dridhej.  
Nuk e mbaj mend ç'të fola e ç'më fole,  
megjithëse kjo dihet.

Edhe ti ishe e lодhur.  
Pranë meje dukeshe e argjendtë.  
Në krahë ne mbanim grurin e korru,  
në drapër — hënën e ngrënë.

## *Teksas, stadiumi i kuajve*

Dhe qeshën qentë, tigrat, elefantët,  
Kuajt në Teksas hingëllinë.

Në kafaz po hynte kllouni i famshëm,  
kinezi Ten Hsiào Pin:

Ç'komedi! — thanë qentë me lehjen e tyre,  
të hyjë një burrë shteti në kafaz.

Cirku është që njeriu nga kafshët të zbavitet  
dhe jo nga njeriu të zbaviten kafshët.

Ç'komedi! — thanë tigrat dhe lëshuan ulërima  
mbi stadiumin e famshëm të kuajve.

Ne vërtet jemi kafshë dhe quhami tigra,  
por ama asnjë nuk qesh dot më ne.

Ç'komedi! — thanë kuajt më hingëllimat e tyre  
dhe zmadhuan sytë për të parë më mirë.  
Kinezi kërkon nga ne duartrokitje,  
po potkonjtë s'duan të lëvizin.

## SHKOPËT KOMEDI

Ne do të ikim — thanë pastaj elefantët.  
Nuk pranojmë që Teni të na godasë me shkop.  
Mjaft, ju kafshë që u gajasët  
me një kloun si ky, kaubojs!

E si mos gajasesh, — tha duke qeshur ariu —  
me një komedi si kjo, gjeniale,  
Kafshët mundohen të ecin drejt njeriut,  
ky mundohet të ecë drejt kafshëve...

## *Kjo ngjau në Floridë...*

Sipas tregimit të një mërgimtari.

Kjo e gjitha ngjau në Floridë,  
në një nga rrugët pyjore të saj.  
Kishim dalë me një shokun tim,  
kishim marrë një veturë me qira.

Dhe ishte e kaltër ajo mbrëmje,  
dhe kundërmonte portokall.  
Era lozta në qindra këngë,  
në atë pyll të zi, të madh

Por pse kështu u trembën zogjtë?  
Pse këto klithma në alarm?  
Katër plumba, nga katër revolverë  
për të na ndalur, qëlluan mbi ta.

Dhe katër zogj përplasën krahët  
dhe ranë mbi xhamat e veturës.  
Vrasësit e tyre, që të katër,  
na prenë udhën.

— Kë doni më shumë — na thanë ata. —  
Kokat tuaja apo veturën tuaj të bukur?  
Dhe ia dhanë të qeshurit, aq sa  
edhe drurët e pyllit filluan të tunden.

Dhe ishte kjo krejt e zakonshme  
në atë shtet jugor, të madh,  
ku mbrëmja ish vërtet e kaltër  
dhe binte erë portokall.

## *Revoltë e një të papuni amerikan*

Portokaj, hurma, banane.

Me shije të ëmbël e të mirë.

Gjithçka e rrëthuar me xhamë  
dhe e mbrojtur me policë.

Veç dora e tij nuk e njeh vitrinën  
dhe varfëria e di mirë këtë.

Por jo lotët, do ta mbytin urinë,  
jo lotët, do ta zhdukin atë.

Në xhepat e tij janë dhjetë gishta të lodhur,  
që s'e kanë harruar, forcën e krahëve.

Ndaj e ndien dhe duhet të ndodhë,  
që grushti i tij të tundet në ajër.

Ndaj e ndien dhe duhet të ndodhë,  
në këtë qytet duhen thyer xhamat.  
Ja ai, proletari i botës,  
i urren këto rrugë dhe reklama.

Ja ai, proletari i botës,  
që bën kolltukun, ku rri presidenti,  
që bën veturën, ku kalben ministrat,  
që e njeh toka, ajri, deti.

Ja ai, proletari i botës  
që nxjerr floririn nga puset e minierës.  
Por në vend të unazës, nëpër duar  
mban hekurat e rënda të zgjedhës.

Ja ai, proletari i botës,  
që mban mbi supe tërë globin.  
Por... dëgjoni! Atë do ta hedh tek duart  
dhe duke luftuar do ta sjell rrötull.

Do të përbysen kolltukët pastaj,  
presidentët, ministrat edhe qeveritë.  
Si mbështetëse, projektues të hartës,  
vini nën glob dorën e tij...



## PASQYRA E LËNDËS

<b>Komunisti</b>	<b>3</b>
<b>Nevruz Gjoka</b>	<b>4</b>
<b>Punëtorët e Fierzës</b>	<b>5</b>
<b>Ndajnatë</b>	<b>6</b>
<b>Partizani</b>	<b>8</b>
<b>Vendosmëri</b>	<b>9</b>
<b>Dy qetë</b>	<b>11</b>
<b>Vajzë që martoreshesh nesër</b>	<b>13</b>
<b>Shqetësim</b>	<b>14</b>
<b>Eriona</b>	<b>15</b>
<b>Nxënësit e mi</b>	<b>17</b>
<b>Nga ditari i një partizani</b>	<b>19</b>
<b>Në shah</b>	<b>21</b>
<b>Vaditësit</b>	<b>23</b>
<b>E zakonshme</b>	<b>24</b>
<b>Nuk është aq e thjeshtë</b>	<b>25</b>
<b>Meditim</b>	<b>26</b>
<b>Po të më pyesni</b>	<b>27</b>
<b>Karrocieri</b>	<b>28</b>
<b>Vajzë</b>	<b>30</b>
<b>Pensionisti</b>	<b>32</b>
<b>Balta</b>	<b>33</b>
<b>Kuptoje</b>	<b>34</b>
<b>Ura e Bruklinit, 1978</b>	<b>36</b>
<b>Grua</b>	<b>38</b>
<b>Opingat</b>	<b>39</b>
<b>Shoqërore</b>	<b>40</b>
<b>Kurbatka</b>	<b>42</b>
<b>Kur bie borë</b>	<b>44</b>
<b>Intime</b>	<b>45</b>
	<b>73</b>

Në lëmin e fshatit .....	46
Njoh një njeri... .....	47
Era .....	49
Troket një vishnjë .....	50
Babai .....	51
Vishocica .....	52
Të lutem, hiqe kapelen .....	54
Fëshfërima e një molle .....	55
Nevada, 1979 .....	56
Një ngjarje e thjeshtë .....	58
Meditim në vjeshtë .....	60
Ardhka një moshë .....	61
Patjetër .....	62
Muzikanti .....	63
Lirikë .....	65
Teksas, stadiumi i kuajve .....	66
Kjo ngjau në Floridë .....	68
Revoltë e një të papuni amerikan .....	70

Rusi, S.

Lirikë: Poezi. [Red.: P. Jorgoni]. T.,  
«Naim Frashëri», 1982.

76 f.

(B.m.) dhe  
(B.v.) : 891.983-1

R 95

Tirazhi 1500 kapje      Formati 70x100/32      Stash: 2204-79

Kombinati Poligrafik Shtypshkronja e Re Tiranë 1982